

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me Sek.juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit [REDACTED] me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED] nga Prishtina, me autorizim, kundër të paditurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] për çështjen kontestuese rimbursim i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me dt.02.05.2017, në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesën e të paditurës, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED]. Kaçanik që paditësit të i'a paguaj shumën prej 590 €, në emër të rimbursimit të dëmit, këtë shumë me kamatë prej 8% duke filluar nga data 02.05.2017 e gjeri në pagesën definitive.

II. DETYROHET, e paditura që paditësit të i'a paguajë shumën si në pikën I të këtij dispozitivit të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 20€, të gjitha këto pagesa do të paguhet në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së sajë, si në padi ashtu edhe në shqyrtimin e mbajtur gjyqësore, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që paditësit të i'a paguaj shumën prej 590 €, për dëmin të cilin i'a kanë shkaktuar me fajin e tij.

E autorizuarja e paditësit ka deklaruar se i padituri më datën 17.02.2012, në Ferizaj, ka shkaktuar aksident komunikacioni, në këtë aksident i ka shkaktuar dëm [REDACTED] nga Ferizaji, këtë aksident e ka shkaktuar sepse i padituri e ka drejtuar automjetin e markës "Opell Fronterea", me targ të regjistrimit [REDACTED] të pa siguruar.

Ka theksuar se pala e cila ka pësuar dëm, është kompenzuar nga paditësi këtë fakt gjyqësor mund ta vërtetojë nga "ujdia jashtë gjyqësore" e datës 10.05.2013, nga e cila vërtetohet se paditësi e ka përmbushur detyrimin ndaj [REDACTED] dhe e ka paguar shumën prej 590 €, sepse ky dëm është shkaktuar me fajin e tanit të paditurit, nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë ta miratojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar

Gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka mbajtur në mungesën e të paditurës sepse e njëjta ka qenë e ftuar me rregull, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka këkuar shtyerjen e shqyrtimit gjyqësor conform nenit 423.4 të LPK-së.

Shpenzimet i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyr të drejtë në këtë çështje kontestimore të regjiresimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara, u lexuan: transferi nga kopja , ujdija jashtë gjyqësore , vendimi i dt. 04.05.2012, aktvlerësimi i dëmit , fotot e automjetit të dëmtuar ,raporti i aksidentit, aktvendimi RI.nr.548/12 , dhe deklarata e të paditurit, pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas vlersimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veq e veq dhe të gjithave bashkarisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatë, kjo gjykatë për këtë çështje kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt. 17.02.2012, ky aksident është shkaktuar me fajin e të paditurit [REDAKTUAR], sepse e njëjta e ka drejtuar automjetin e pa siguruar, si rezultat i këtij aksidentit paditësi ka pësuar dëm, sepse të dëmtuarës [REDAKTUAR], i'a ka paguar dëmin në shumë prej 590 €.

Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt. 17.02.2012, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga padia e paditësit, raporti i i aksidentit dhe policit hetues si dhe provave të tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Se aksidenti është shkaktuar me fajin e tani të paditurit këtë fakt gjykata e vërtetoi nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e në të cilat është konstatuar se i padituri me automjetin e markës „Opell Fronterea”, me targ të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilin e ka drejtuar të pa siguruar e për të cilin rast nuk ekziston mbulesa e sigurimit.

Se paditësi e ka paguar dëmin në shumë prej 590 €, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ujdija jashtëgjyqësore e dt. 10.05.2013 dhe aktvlerësimi i dëmit, nga e cila vërtetohet se paditësi B [REDAKTUAR] personit [REDAKTUAR] i'a ka paguar dëmin në shumë prej 590 €.

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të j'a paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse aksidenti është shkaktuar me fajin e të paditurit, këtë dëm paditësi e ka paguar dhe i padituri ka detyrim që ta kompenzoj sepse kompania e sigurimit e ka paguar zhdëmtimin pa qenë e detyruar ta paguaj në bazë të kontratës së sigurimit dhe kushteve të sigurimit të autopërgjegjësisë, e subrogon të dëmtuarin në relacion me të siguruarin apo gjdo person tjetër përgjegjës për dëmin deri në shumën e zhdëmtuar me kamatë dhe shpenzimet e procedurës, e kjo çështje është e rregulluar me nenin 3.1, demt ndaj perosnave të tretë të rregullit 3 mbi ndryshimet e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë.

Po ashtu kjo çështje është e rregulluar edhe me nenin 14 par.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, me të cilën dispozitë është paraparë e drejta e rimbursimit në procedurën e regresit ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese dhe vendosi si në dispozitiv të

aktgjykimit, ndërsa si dispozita materiale zbatohet nenet 939 të LMD-së, dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata i analizoj të gjitha theksimet e palës paditëse e cila i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar e të cilat theksime gjykata ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtijë aktgjykim sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurit sepse i njejtë e ka vozitur automjetin e markes "Mercedes", pa polisë të sigurimit, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të i'a kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20 € ,në emër të takses për padi të parapara me Udhëzimin Administrativ mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore nr.01/2017 si dhe konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithëshme të procedurës kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.68/14 e dt.02.05.2017

Gjyqtari
Riza Livoreka



UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtijë aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimt të këtijë aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

